

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsha Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Sami Kurteshi nga Prishtina, përfaqësuar me autorizim nga Geotar Mjeku, kundër të paditurit – Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në Prishtinë, dhe palët me interes juridik ‘VBS’ shpk, ‘Vita Energy’ shpk, ‘Abrazen’ LLC, Energy Development Group Kosova shpk, ‘Solar Gate’ LLC dhe ‘Alsi and Co.Kosovë’ LLC shpk, ‘Building Construction’, përfaqësuar me autorizim nga Faton Qirezi dhe Alban Makolli, avokat në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi të të paditurit V-1204-2019 dt.27.11.2019, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën e të paditurit dhe të palëve me interes juridik, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.355/2020 dt.17.06.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me 23.07.2020, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara kërkesat e të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji dhe palëve të interesuara ‘VBS’ shpk, ‘Vita Energy’ shpk, ‘Abrazen LLC, ‘Energy Development Group Kosova shpk, ‘Solar Gate’ LLC, dhe ‘Alsi and Co Kosovë’ LLC shpk, ‘Building Construction’, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.355/2020 të datës 17.06.2020.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.355/2020 të datës 17.06.2020, janë refuzuar si të pabazuara ankesa e të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji, ankesa e palëve të interesuara VBS shpk, Vita Energy shpk, Abrazen LLC, Energy Development Group Kosova shpk, Solar Gate, LLC dhe Alsi and Co Kosovë LLC shpk, Building Construction, ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative A.U.nr.3090/2019 dt.06.04.2020, me të cilin është aprovuar propozimi i paditësit Sami Kurteshi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e të paditurit - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), V-1204-2019 dt.27.11.2019.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.355/2020 dt.17.06.2020 i padituri ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, për shkak të shkeljes të së drejtës materiale dhe

te shkeljes së dispozitave të procedurave, me propozim që të aprovohet kërkesa dhe të ndryshohet aktvendimi i kontestuar dhe të aprovohet ankesa e të paditurit.

Kundër këtij aktvendimi kanë ushtruar kërkesë për rishqyrtim edhe palët e interesuara VBS shpk, Vita Energy shpk, Abrazen LLC, Energy Deveopment Group Kosova shpk, Solar Gate LLC dhe Alisi and Co Kosovë LLC shpk, Building Construction, me të cilën e kanë kontestuar ligjshmërinë e aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, AA.UZH.nr.355/2020 dt.17.06.2020, për shkak të shkeljes së dispozitave të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet kërkesa dhe të ndryshohet aktvendimi i kontestuar dhe të refuzohet propozimi i paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të paditurit, ose të anulohet aktvendimi dhe çështje të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktvendimit të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.355/2020 dt.17.06.2020 janë refuzuar si të pabazuara ankesat e të paditurit ZRRE dhe të palëve të interesuara VBS shpk, Vita Energy shpk, Abrazen LLC shpk, Energy Development Group Kosova shpk, Solar Gate LLC dhe Alsi and Co Kosovë LLC shpk, Building Construction, ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë , A.U.nr.3090/2019 dt.06.04.2019 me të cilin është aprovuar propozimi i paditësit Sami Kurteshi, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të paditurit ZRRE, V-1204-2019 dt.27.11.2019, deri në marrjen e aktgjykimit të shkallës së parë sipas padisë së paditësit.

Neni 22.2 i Ligjit për Konfliktet Administrative parasheh se shtyrja mund të bëhet me kërkesën e paditësit, organi,akti i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyje ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Ndërsa me dispoziten e nenit 22.6 të të njëjtit ligj përcaktohet se paditësi mund të kërkoj nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor , sipas kushteve të paraparë në nenin 22 par.2 të LKA-së .

Gjykata Supreme e Kosovës, duke i marrë parasysh dispozitat e lartpërmendura gjen se gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejtë, duke i refuzuar si të pabazuara ankesat e të paditurit dhe të palëve të interesuar, dhe duke e vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, A.U.nr.3090/2019 dt.06.04.2019, me të cilin është aprovuar propozimi i paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit e të paditurit me nr.V-1204-2019 dt.27.11.2019, deri në marrjen e aktgjykimit të shkallës së parë sipas padisë së paditësit. me të cilin është hedhë propozimi i paditësit.

Pra, në këtë rast, kjo Gjykatë vlerëson se i padituri dhe palët të interesuar nuk kanë bërë të besueshëm me asnjë provë të vetme faktin se shtyrja e ekzekutimit, nuk është në kundërshtim me interesin publik. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ e me të cilin do të arsyetohej shtyrja

e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ngjore të nenit 22 të LKA-së. Për këto arsye, kjo Gjykatë vendosi të refuzoj kërkesat e të paditurit dhe të palëve të interesuar, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA nr.355/2020 dt.17.06.2020.

Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit, dispozitat e procedurës administrative, ato të Ligjit për konfliktin administrativ. Janë të pabazuara thëniet e të paditurit dhe të palëve të interesuar lidhur me shkeljet, ngase vendimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm. Arsyetimi i aktvendimit të goditur përmbanë arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se është bërë aplikimi i drejtë të së drejtës materiale dhe nuk është shkelur ligji në dëm të të paditurit dhe të palëve të interesuar.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54.1 lidhur me nenin 22 par 2 dhe 6 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

ARJ-UZVP nr.44/2020 dt. 23.07.2020

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Nebojsha Boriçiq

Përktheu: Ferid Abazi

